

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm- Penal,** gjyqtari, Kujtim Krasniqi, me procesmbajtësin Petrit Nrecaj, në çështjen penale të pandehurit I.Gj nga P, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par.3 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1315/16, të datës:09.03.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit Fillestar, në prezencën prokurorit të shtetit Armend Hamiti, të akuzuarit, e me dt:11.03.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### **I akuzuari;**

**I.Gj,** nga babai S dhe nëna R, e vajzërisë L, i lindur më dt. *data e lindjes*, në fshatin T, K.D, me vendbanim në P, Rr” H M” nr., me numër personal *numri personal*, ka të kryer shkollën e mesme, invalid-veteran, i martuar, baba i 4 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

**Sepse,** me dt: 08.03.2016, rreth orës 23:20 minuta, në rrugën “H M” nr.. në P, i pandehuri I.Gj nën ndikim të alkoholit pasi që kërkon nga bija e tijë tani e dëmtuara V.Gj që të i shtroj shtratin, të njëjtën e sulmon me qëllim qe ti shkaktoj dhimje duke përdor forcën e godet me shuplakë në fytyrë dhe e njëjta arrin të ik dhe hyj në dhomën tjetër ku mbyllet dhe thërret policin.,

**-me këtë ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 187 par.3 të KPRK-së**

Andaj gjykata konform nenit 4,7, 49, 51,52, 73 të KPK-së si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të njëjtit i shqipton,

### DËNIMIN ME KUSHT

Të akuzuarit I.Gj, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej **6** (gjashtë) muajve, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekutoj ne afatin kohor prej **2** (dy) vjetëve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër te re penale.

**Obligohet;** i akuzuari që të në emër të paushallit gjyqësor, gjykatës t’ia kompensojë shumën prej **20 euro**, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

**E dëmtuara:** V (I) Gj me vendbanim në P Rr” H M” nr.. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.1315/16, të datës:09.03.2016 kundër të akuzuarit I.Gj nga P, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par.3 të KPRK-së

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar, dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurit i është dhënë mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar me vullnet të plotë dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorisë së shtetit, PP.II.nr.1315/16, të datës:09.03.2016.

Pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i Shtetit Armend Hamiti dha mendimin e tij lidhur me deklarimin e fajësisë së të pandehurit, dhe shtoi se pranimi është në pajtim me nenin 248 të KPPK-së, e me theks të veçantë e mbështetur në provat dhe shkresat e lëndës dhe i propozoi gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit ndërsa me rastin e matjes së dënimit gjykata ta merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

I pandehuri deklaroi se për këtë veprë penale ndihet fajtor dhe përgjegjës, se është penduar shumë për atë çka ka ndodhur, dhe i premtoj gjykatës se do të jem më i kujdesëm me veprimet dhe sjelljet e mia, i propozoj gjykatës që gjatë matjes së dënimit të më shqiptoj një dënim sa më të butë që është i mundur.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin fillestar u vërtetua se ai me datë kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: Deklarata e të dëmtuarës e dhënë në polici, Deklarata e të dyshuarit ë dhënë në Polici, pranimi i fajësisë në shqyrtimin fillestarë, dokumentacioni që gjenden në shkresat e lëndës, i gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale Sulmi nga neni 187 par.3 të KPRK-së, për të cilën akuzohet i pandehuri, andaj, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, pasi qe gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe e gjykoj si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se: i pandehuri e pranoi fajësinë për veprën penale, se ishte korrekt dhe me sjellje korrekte në gjykatë, dhe se i ka premtuar gjykatës së më nuk do të përsërisë vepra penale, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, dhe duke u nisur nga të gjitha këto gjykata i shqiptoi dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit,i paraparë me nenin 50 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73.par.2, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 të KPPK-së

Në bazë të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPK, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 326 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti i përgjithshëm-Penal**  
**P.nr.1097/16, të dt:11.03.2016**

**Sekretari juridik,**  
Petrit Nrecaj

**Gjyqtari,**  
Kujtim Krasniqi

**UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.